



Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Vlerësim për këmbimin e informatave personale nga regjistrat publikë në procesin e përditësimit të regjistrat të zgjedhësve

Vizitë e ekspertëve të OSBE/ODIHR-it
16 – 19 shtator 2013



Varshavë
12 dhjetor 2013

Përmbajtja

I.	HYRJE DHE MIRËNJOHJE.....	1
II.	PËRMBLEDHJE	2
III.	SFONDI.....	4
IV.	KONSTATIMET E VLERËSIMIT.....	5
	MBAJTJA E REGJISTRIT TË ZGJEDHËSVE	5
	REGJISTRAT QË SHFRYTËZOHEN PËR PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT TË VOTUESVE .	7
	a) Regjistrimi i ngjarjeve vitale të jetës	7
	b) Lajmërimi i vendbanimit dhe dhënia e letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit me karakteristika biometrike.....	8
	c) Regjistri i adresave	11
	d) Këmbimi i informatave ndërmjet institucioneve shtetërore	12
	e) Kompetenca për ndryshimin e informatave në listën zgjedhore	12
V.	AVANCIMI I MBLEDHJES DHE I KËMBIMIT TË INFORMATAVE NË TË ARDHMEN.	13
	AKTIVITETET QË MUND TË NDËRMERREN NË AFAT TË SHKURTË.....	13
	AKTIVITETET QË MUND TË NDËRMERREN NË AFAT TË GJATË	15

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

VLERËSIM PËR KËMBIMIN E INFORMATAVE PERSONALE NGA REGJISTRAT PUBLIKË NË PROCESIN E PËRDITËSIMIT TË REGJISTRIT TË ZGJEDHËSVE

I. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Pas ftesës së marrë nga Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ) i Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë për ta bërë vlerësimin e mënyrës në të cilën këmbehen informatat personale nga regjistrat e qytetarëve në procesin e përditësimit të regjistrat të votuesve, Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) dërgoi një ekip ekspertësh (Ekipi) në Shkup prej 16 deri më 19 shtator 2013. Ekipi i OSBE/ODIHR-it përbëhej nga z. Zoran Gjokoviq, këshilltar për migrim/liri të lëvizjes i OSBE/ODIHR-it dhe z. Nikollai Vullçanov, ekspert i jashtëm.

Kjo vizitë e ekspertëve u organizua si vazhdimësi e rekomandimeve nga Misionet e mëparshme për vëzhgim të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it dhe si përpjekje për t'u ndihmuar autoriteteve dhe palëve të tjera të rëndësishme në implementimin e tyre. Vizita ishte në përputhje me përkushtimin e bërë nga të gjitha vendet anëtare të OSBE-së në Kartën për siguri evropiane të vitit 1999, dhe të riafirmuar në Konferencën ministrore të vitit 2002 të mbajtur në Porto, për veprim të menjëhershëm për vlerësimet dhe rekomandimet zgjedhore të OSBE/ODIHR-it.¹

Ekipi e vlerësoi procesin e përditësimit të të dhënave të votuesve që gjenden në listat zgjedhore në bazë të informatave personale, duke i përfshirë evidencat zyrtare të identitetit, të ngjarjeve vitale dhe të vendbanimeve, që ruhen në librat e amzës, evidencat e vendbanimeve dhe në evidencat e tjera që udhëhiqen nga institucionet relevante shtetërore. Ekipi e shqyrtoi kornizën rregullatore që zbatohet dhe i identifikoi fushat ku mund të bëhen përmirësime. Me qëllim që të bëhet vlerësimi i kualitetit të informatave që ruhen në librat e amzës dhe në evidencën e vendbanimeve dhe si reflektohet kjo në saktësinë e listave zgjedhore u analizua edhe korniza administrative për mirëmbajtjen e regjistrat të adresave, dhe në fund, ekipi i shqyrtoi edhe masat afatshkurta dhe afatmesme që mund të ndërmerren për ta përmirësuar efikasitetin e mbledhjes së të dhënave personale të votuesve, përditësimin dhe këmbimin e tyre nga institucionet shtetërore dhe ndërmjet tyre.

OSBE/ODIHR-i i është mirënjohës KSHZ-së për ftesën e bërë dhe për mundësinë që të kontribuojë në përpjekjet e saj që kanë për qëllim rritjen e saktësisë së listave zgjedhore, si dhe për përkrahjen e KSHZ-së në organizimin e vizitës së ekipit dhe gatishmërinë e të

¹ Karta për siguri evropiane, Stamboll, 1999; <http://www.osce.org/mc/17502>;

Mbledhja e dhjetë e Këshillit të ministrave, Porto, 2002; <http://www.osce.org/mc/40521>

punësuarve të saj për të diskutuar. OSBE/ODIHR-i dëshiron t'u shprehë falënderim institucioneve dhe individëve të tjerë për çiltërsinë dhe gatishmërinë për t'i ofruar pikëpamjet e tyre për çështjet e diskutuara gjatë vizitës (shihni listën e bashkëbiseduesve në Aneksin 1). Poashtu e çmojmë lartë edhe përkrahjen që ia ofroi ekipit Misioni i OSBE-së në Shkup.

II. PËRMBLEDHJE

Me Kodin zgjedhor të “ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë” (Kodi zgjedhor), KSHZ-ja e ka për detyrë ta mirëmbajë regjistrin e zgjedhësve, nga i cili nxirren listat zgjedhore, dhe ta sigurojë saktësinë e tyre. Deri tani, KSHZ-ja ka kapacitet të kufizuar për ta mirëmbajtur regjistrin e zgjedhësve dhe për këtë arsye, regjistri votues udhëhiqet nga Enti shtetëror për statistikë (ESHS). Poashtu, për arsyen e njëjtë, KSHZ-ja nuk bën kontroll të mjaftueshëm të kualitetit mbi listat zgjedhore.

Gjatë përditësimit të regjistrit të zgjedhësve, KSHZ-ja i shfrytëzon informatat për identitetin personal, ngjarjet vitale të jetës dhe vendbanimin, të cilat i ofrojnë institucionet që janë paraparë me Kodin zgjedhor. KSHZ-së i duhet të zhvillojë një metodologji të detajuar për ta vlerësuar regjistrin e zgjedhësve sa i përket informatave që mund të ndihmojnë në identifikimin e mospërputhjeve eventuale në të dhënat e votuesve ose për keqpërdorimin e mundshëm të procedurave për regjistrimin e votuesve, gjë që duhet trajtuar në të ardhmen.

Në bazë të Kodit zgjedhor, KSHZ-ja nuk ka kompetenca të mjaftueshme ligjore për t'i ndryshuar informatat në regjistrin e zgjedhësve, të cilat i kanë dorëzuar institucionet relevante. Edhe pse kontrollimi i regjistrit të zgjedhësve nga ana e KSHZ-së mund të kërkojë nga KSHZ-ja të rishqyrtojë informata të caktuar në regjister, ndryshime mund të bëhen vetëm në qoftë se ato janë të shoqëruara me informata personale që janë ligjërisht të vlefshme. Përveç në rastet kur informatat e pasakta janë rezultat i gabimeve që janë paraqitur në procesin e transferimit, të gjitha pasaktësitë e tjera në regjistrin e zgjedhësve dhe në listat zgjedhore janë të trashëguara nga informatat që dorëzohen nga institucionet relevante shtetërore, të cilat kanë kompetencë ligjore për evidentimin dhe mirëmbajtjen e tyre. Prandaj, është kontestuese se a duhet të jetë KSHZ-ja institucioni që duhet t'i rregullojë pasaktësitë e tilla.

Të dhënat personale të votuesve të cilat i ofron Ministria për Punë të Brendshme (MPB) janë burimi kryesor i informatave që shfrytëzohen për përpilimin e regjistrit të zgjedhësve. Në procesin e përditësimit të informatave në regjistrin e zgjedhësve, MPB-ja ofron informata që janë të vlefshme ligjërisht sa i përket identitetit dhe vendbanimit të votuesve. Roli i MPB-së është i rëndësishëm me faktin se vetëm ata qytetarë që kanë letërnjoftim valid, të lëshuar nga MPB-ja, mund të përfshihen në listat zgjedhore. Prandaj, saktësia e informatave të ofruara nga MPB-ja në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në saktësinë e listave zgjedhore.

Si duket, MPB-ja bën kontroll të kufizuar për të siguruar se informatat për ndonjë vendbanim të evidentuar janë të përditësuara. Disa votues mund të mos jetojnë në vendbanimet ku janë të regjistruar si rezultat i asaj se nuk i kanë njoftuar institucionet për ndryshimin e vendbanimit. Përderisa mekanizmi që siguron se qytetarët do ta respektojnë kërkesën ligjore për ta paraqitur ndryshimin e vendbanimit është i bazuar në gjoba, duhet menduar për zhvillimin e shtytësve të tjerë, që qytetarët t'i raportojnë në kohë ndryshimet e vendbanimeve, që të

evitohen situatat ku në evidencën e vendbanimeve mbetet vendbanimi paraprak edhe pse mund të ketë marrë fund e drejta për të banuar në atë vend.

Votuesve që kanë vendbanim afatgjatë jashtë vendit ose që jetojnë përherë jashtë vendit, u jepen pasaporta dhe ata përfshihen në listat zgjedhore në bazë të adresës së tyre të fundit në vend që është e njohur. Mund të rishqyrtohet përdorimi i adresës së fundit të njohur si kriter për t'u dhënë pasaportë qytetarëve të tillë, me qëllim që të mbrohet e drejta e tyre për të votuar dhe që të sigurohet se listat zgjedhore nuk do të perceptohen si të fryra nga ana e publikut.

Drejtoria për mbajtjen e librave të amzës (Drejtoria) në kuadër të Ministrisë për drejtësi (MD) është përgjegjëse për evidentimin e informatave personale që janë ligjërisht të vlefshme për identitetin dhe ngjarjet vitale të jetës së qytetarëve. Mirëpo, roli i Drejtorisë në procesin e përditësimit të informatave në regjistrin e zgjedhësve është i kufizuar në ofrimin e informatave për votuesit që kanë vdekur, të cilat i përcillen KSHZ-së nëpërmjet përditësimeve të rregullta nga MPB-ja dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet zyrave rajonale të KSHZ-së.

Këmbimi i informatave për popullatën dhe votuesit ndërmjet institucioneve, në përgjithësi funksionon, por kjo bëhet duke përdorur nivele të ndryshme të teknologjisë, duke përfshirë këmbim të informatave të shtypura në letër ose kopjim të sasive të mëdha të të dhënave në kompakt disqe (CD), në vend që të ketë qasje të drejtpërdrejtë onlajn në të dhënat që mirëmbahen nga institucionet e tjera.

Në afat të shkurtër, KSHZ-ja duhet të përpilojë disa pyetësorë të detajuar për ta vlerësuar saktësinë e regjistrit të zgjedhësve dhe ta njoftojë publikun rregullisht me ndryshimet që bëhen në regjistrë. Këto aktivitete mund të shërbejnë për ta rritur edhe më shumë besimin e publikut në listat zgjedhore. KSHZ-ja, poashtu duhet të bëjë një kontrollim të regjistrit të zgjedhësve, për t'i zbuluar informatat, të cilat pastaj do të duhej të shqyrtohen nga organet që janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e tyre. Kjo është posaçërisht e rëndësishme kur bëhet fjalë për informatat që kanë të bëjnë me numrin e ndryshimeve të vendbanimeve në një komunë të caktuar, ose kur janë evidentuar numra jashtëzakonisht të lartë të njerëzve që banojnë në adresën e njëjtë.

Në aspekt afatgjatë, do të ishte e dobishme të vlerësohet efektiviteti në aspekt të harxhimeve i mbajtjes së regjistrit të zgjedhësve paralelisht me librat amzë të qytetarëve që mbahen nga MPB-ja e që në të ardhmen do të mbahen nga Drejtoria në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë kontekst, mund të mendohet për atë se a duhet, cilido qoftë nga këto dy institucione që kanë përgjegjësi ligjore për evidentimin e informatave personale të jetë përgjegjës për përpilimin e listave zgjedhore në bazë të informatave që ato i kanë që më parë, dhe a mund të arrihet konsensus politik për një vendim të tillë. Përndryshe, mund të ketë nevojë që në tërësi të zhvillohet kapaciteti i KSHZ-së për ta marrë përgjegjësinë për mbajtjen e regjistrit të zgjedhësve.

III. SFONDI

Kualiteti i listave zgjedhore është një çështje shumëvjeçare. Për këtë çështje janë dhënë vërejtje në raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve dhe në mendimet e përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit për demokraci nëpërmjet ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut).² Këto dokumente e potencojnë nevojën për rishqyrtimin dhe revizionin e listave zgjedhore me qëllim që të rritet saktësia e tyre dhe të përmirësohet besimi i publikut në procesin e evidentimit të votuesve. Në Raportin përfundimtar të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, potencohet se të drejtë vote kishin 1.82 milionë qytetarë, nga popullata e përgjithshme, që parashihet se është 2.05 milionë njerëz. Më tutje në raport theksohet se dallimi ndërmjet numrit të votuesve të evidentuar dhe numrit të paraparë të popullatës çoi në “[...] *dyshime të vazhdueshme për saktësinë e listave zgjedhore*[...]” dhe u rekomandua që “[...] *të bëhet një rishqyrtim dhe revizion i themeltë i listave zgjedhore*[...] që do të fokusohet në të dhënat e personave të vdekur dhe qytetarët që jetojnë jashtë vendit [...]”³

Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2011 dhe në bazë të një marrëveshjeje të gjerë politike, autoritetet bënë një interpretim të nenit 41(4) të Kodit zgjedhor⁴, kështu që pas 29 shkurtit të vitit 2012, termi “dokumente të vlefshme” nënkupton dhënien e letërnjoftimit ose pasaportës (ndërkombëtare) të re me karakteristika biometrike. Për t’i shqyrtuar rekomandimet e Raportit final të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, në vitin 2012 qeveria e krijoi Grupin e punës për Listat zgjedhore që kishte për detyrë t’i shqyrtojë listat zgjedhore dhe të definojë politika që do ta rrisin saktësinë e listave zgjedhore. Grupi i punës u koncentrua në mbikëqyrjen e përparimit të dhënies së letërnjoftimeve të reja dhe pasaportave të reja biometrike, sepse posedimi i këtyre dokumenteve e përcakton të drejtën e votimit.

Për zgjedhjet lokale që u mbajtën në muajin mars të vitit 2013, 1,743,403 votues kishin të drejtë vote dhe ishin përfshirë në listat zgjedhore. Në krahasim me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2011, rreth 119,000 njerëz ishin hequr nga listat zgjedhore për shkak se nuk posedonin letërnjoftim ose pasaportë biometrike. Në raportin e saj përfundimtar për këto zgjedhje, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it theksoi se vazhduan ankesat sa i përket saktësisë së listave zgjedhore, duke e potencuar edhe besimin e rritur të publikut në saktësinë e listave zgjedhore. OSBE/ODIHR-i rekomandoi që “[...] *Duhet të shqyrtohen procedurat për përpilimin dhe mbajtjen e listave zgjedhore. Procedurat e qarta, të koordinuara dhe*

² Rekomandimet e vazhdueshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut se duhet të bëhet një revision i themeltë i listave zgjedhore akoma nuk janë zbatuar. <http://www.osce.org/odihr/elections/fyrom/69936>.

³ Shihni raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it (faqja 20) në <http://www.osce.org/odihr/elections/FYROM/83666>.

⁴ Neni 41(4) i Kodit zgjedhor parasheh se të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet dhe kanë vendbanim në territorin e vendit, si dhe kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme, duhet të regjistrohen në listat zgjedhore.

transparente do ta përmirësonin saktësinë e listave zgjedhore dhe do të kontribuonin në rritjen e besimit të publikut. [...].”⁵

Duke u bazuar në nenin 42 të Kodit zgjedhor, evidentimi i ngjarjeve vitale të jetës që e përcaktojnë identitetin personal, siç është lindja, vdekja, dhe martesë ose divorci, si dhe evidentimi i vendbanimit të përhershëm, janë shumë të rëndësishëm për përpilimin e listës së saktë zgjedhore.⁶ Prandaj, ekipi u fokusua në këto procedura, me qëllim që t'i vlerësojë ato në kontekst të mbledhjes, përditësimit dhe këmbimit të të dhënave personale të qytetarëve që kanë të bëjnë me ngjarjet vitale të jetës dhe vendbanimet e përhershme, ndërmjet institucioneve.

IV. KONSTATIMET E VLERËSIMIT

MBAJTJA E REGJISTRIT TË ZGJEDHËSVE

Regjistrimi i votuesve është i rregulluar me nenet 2, 5-6, 31 dhe 41 – 56 të Kodit zgjedhor. Të drejtë vote kanë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet, që banojnë në njësi zgjedhore ose komunë ku mbahen zgjedhjet dhe që kanë letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme. Qytetarët e ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit në vendvotimin që gjendet në zonën e përcaktuar nga KSHZ-ja dhe ku ata e kanë regjistruar vendbanimin e tyre. Kodi zgjedhor nuk përcakton ndonjë kusht se votuesi duhet të banojë në njësinë e dhënë zgjedhore për një periudhë të caktuar kohore para ditës së zgjedhjeve, që të ketë të drejtë vote.

Në përputhje me nenin 41(2) të Kodit zgjedhor, KSHZ-ja është përgjegjëse për mbajtjen e regjistrit të zgjedhësve, nga i cili nxirren listat zgjedhore. Mirëpo, edhe pasi kompetenca për regjistrimin e votuesve u transferua nga MD-ja në KSHZ në vitin 2009, KSHZ-ja akoma nuk i ka resurset përkatëse për ta menaxhuar regjistrin e zgjedhësve dhe për t'i përpiluar listat zgjedhore pa përkrahje të jashtme. Në përputhje me nenin 203 të Kodit zgjedhor, derisa KSHZ-ja të jetë e gatshme teknikisht ta mbajë regjistrin e zgjedhësve pa përkrahje të jashtme, atë e mban ESHS-ja. Ekipi u informua se po të bëhet investim adekuat për zgjerimin e kapacitetit teknik të KSHZ-së, KSHZ-ja ndjehet e gatshme ta mbajë regjistrin e zgjedhësve. Njëkohësisht, ekipi u informua se është duke u realizuar një projekt nga KSHZ-ja, që ka për qëllim kompjuterizimin e zyrave rajonale të saj dhe sigurimin e lidhjes onlajn me KSHZ-në. Në të njëjtën kohë, mund të thuhet se akoma nuk janë zhvilluar projekte konkrete dhe studime të realizueshmërisë (fizibilitetit) që do të kishin për qëllim ndërtimin e kapacitetit të brendshëm të KSHZ-së për ta mbajtur regjistrin e zgjedhësve.

Përderisa ESHS-ja i përpunon informatat që kanë të bëjnë me regjistrin e zgjedhësve dhe i nxjerr listat zgjedhore, KSHZ-ja e mbikëqyr procesin e regjistrimit të votuesve dhe i koordinon aktivitetet për sigurimin e informatave nga institucionet e tjera që e kanë për detyrë të ofrojnë informata për përditësimin e regjistrit të zgjedhësve. Ka tre lloj informatash

⁵ Shihni raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it (faqja 24) në <http://www.osce.org/odihr/elections/103411>

⁶ Neni 42 (1) i Kodit zgjedhor e parasheh obligimin e Komisionit shtetëror të zgjedhjeve për t'i regjistruar, plotësuar dhe për t'i fshirë të dhënat nga listat zgjedhore, në bazë të të dhënave nga librat e amzës, evidenca e vendbanimeve dhe shtetësisë, evidencat e tjera zyrtare dhe me kontrollim të drejtpërdrejtë.

që KSHZ-ja ia jep ESHS-së për përditësimin e regjistrit të votuesve: lloji i parë i të dhënave ka të bëjë me informatat për ndarjen e zonave të vendvotimeve, që përcaktojnë se nga cilat rrugë dhe adresa përbëhet secili vendvotim. Lloji i dytë i të dhënave ka të bëjë me informatat për personat që kanë vdekur, të cilat mblidhen nga zyrat rajonale të KSHZ-së. Lloji i tretë i të dhënave ka të bëjë me informatat për ndryshimet e informatave personale në regjistrin e zgjedhësve, që janë bërë me kërkesë të votuesve, drejtpërdrejt në zyrat rajonale të KSHZ-së. Për zgjedhjet lokale të vitit 2013, KSHZ-ja për herë të parë i shtypi listat zgjedhore për çdo vendvotim, të cilat ishin ofruar nga ESHS-ja.

Kodi zgjedhor e definon se cilat informata personale që janë ligjërish të vlefshme përdoren për përditësimin e regjistrit të zgjedhësve dhe cilat institucione janë përgjegjëse për t'i ofruar këto informata. Sa i përket vëllimit të informatave që çdo institucion ia ofron ESHS-së për ta përditësuar regjistrin e zgjedhësve, MPB-ja është institucioni më i rëndësishëm që ofron informata që janë ligjërish të vlefshme. Të dhënat që i ofron MPB-ja bazohen në librin amzë të letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit (me karakteristika biometrike) që janë dhënë, e të cilat i përmbajnë të gjitha informatat e rëndësishme për identitetin e votuesve (emrin, mbiemrin, emrin e njërit prind), ngjarjet vitale të jetës (datëlindjen, informatat për votuesit që kanë vdekur) dhe vendbanimin (adresën). Në fund, informatat që i ofron MPB-ja për letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit që i ka dhënë, duke e përfshirë edhe vlefshmërinë e tyre, në mënyrë të drejtpërdrejtë përcakton se kush mund të shtohet në listat zgjedhore. MPB-ja e ka përgjegjësinë që informatat e lartpërmendura rregullisht t'ia dorëzojë KSHZ-së dy herë në vit dhe një ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.

Përveç informatave që i merr nga MPB-ja, ESHS-ja poashtu pranon në mënyrë të vazhdueshme informata për votuesit që kanë vdekur. Informatat mblidhen nga KSHZ-ja, nëpërmjet zyrave të saj rajonale, në bazë të informatave për votuesit që kanë vdekur, të cilat KSHZ-së ia dorëzojnë zyrat regjistruese rajonale që veprojnë në kuadër të Drejtorisë së MD-së. Zyrat rajonale të KSHZ-së, poashtu i dërgojnë edhe informatat për personat që kanë dorëzuar kërkesa për t'i përditësuar informatat e tyre në regjistrin e zgjedhësve, pas prezantimit të dokumentit të vlefshëm për identifikim.

Është me rëndësi të theksohet se sipas procedurave ekzistuese të ESHZ-së për përpunimin e informatave në regjistrin e zgjedhësve, kur informatat që pranohen nëpërmjet përditësimeve të rregullta të MPB-së (informatat për votuesit që kanë vdekur ose informatat e tjera personale) janë të ndryshme nga informatat që ekzistojnë në regjistër, edhe sikur informatat të jenë pranuar nëpërmjet përditësimeve të rregullta nga zyrat rajonale të KSHZ-së, përparësi kanë informatat e reja që janë pranuar nga MPB-ja.

Informatat për rrugët në bazat e të dhënave të MPB-së dhe të ESHS-së janë të kodifikuara, që do të thotë se çdo adresë fizike është e paraqitur si kod unik. Në bazë të kodeve të rrugëve në bazat e tyre me të dhëna, mund të gjendet emri aktual dhe emrat e mëparshëm të rrugës. Për të qenë të sigurt se të dyja institucionet operojnë me të dhënat më të fundit të vlefshme sa u përket emrave të rrugëve, kyçe është informata që e ofron Regjistri qendror, i cili është përgjegjës për verifikimin e emrave të rrugëve që janë ligjërish të vlefshme dhe kodet e tyre përkatëse.

REGJISTRAT QË SHFRYTËZOHEN PËR PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT TË VOTUESVE

a) Regjistrimi i ngjarjeve vitale të jetës

Evidentimi i ngjarjeve vitale të jetës, siç është lindja, vdekja, martesja, duke i përfshirë edhe informatat e tjera të rëndësishme të identitetit (emri, mbiemri, emrat e prindërve) është njëri nga parakushtet themelore të sovranitetit të vendeve, nëpërmjet të cilit shtetet i evidentojnë informatat që janë ligjërisht të vlefshme për identitetin e njerëzve dhe në bazë të të cilave shteti e njih identitetin e personave fizikë, duke i përfshirë edhe raportet e tyre me personat e tjerë.

Evidentimi i ngjarjeve vitale të jetës dhe i informatave të rëndësishme për identitetin është i rregulluar me Ligjin për librin amzë, me të cilin parashihet që Drejtoria në kuadër të MD-së të jetë përgjegjëse për evidentimin, ruajtjen dhe përditësimin e këtyre informatave. Në përgjithësi, parimi fundamental që zbatohet me këtë ligj është se ngjarjet vitale të jetës evidentohen në librin përkatës të amzës që mbahet në vendin ku ka ndodhur ngjarja, me përjashtime të cilat janë paraparë me këtë ligj. Ngjarjet vitale të jetës evidentohen në letër, në dy kopje origjinale. 32 zyrat rajonale të Drejtorisë i raportojnë rregullisht zyrës qendrore për evidentimet që i kanë bërë, dhe secila nga 173 zyrat lokale i raporton zyrës rajonale dy herë në javë.

Shumica e librave amzë që mbahen nga Drejtoria shkruhen në letër. Ekipi u informua se Drejtoria është në proces të blerjes së pajisjeve, të cilat duhet të mundësojnë mbajtjen elektronike të librave amzë. Për këtë qëllim, Drejtoria është duke e bërë digjitalizimin e evidencës aktuale që gjendet në letër, me ç'rast diku rreth 20 për qind e përafërsisht nëntë milionë shënimeve që gjenden në letër, e që janë mbledhur dhe përditësuar që nga viti 1900, tashmë janë futur në bazën elektronike të të dhënave. Pas kompletimit, baza e të dhënave do t'i përfshijë të gjitha të dhënat nga librat amzë të lindjes, vdekjes dhe të divorcit. Qëllimi i Drejtorisë është që ta kompletojë këtë projekt deri në korrik të vitit 2015. Drejtoria nuk e ka ndërmend që t'i skenojë dhe t'i përfshijë në bazën e të dhënave edhe dokumentet origjinale, ku është shënuar ngjarja vitale e jetës; në vend të kësaj, të dhënat nga dokumentet do të transferohen në bazën elektornike të të dhënave duke i futur ato në mënyrë manuale. Drejtoria poashtu planifikon që t'i kontrollojë edhe një herë të dhënat që janë ruajtur në bazën e re të të dhënave me informatat për qytetarët që gjenden në bazën e të dhënave të MPB-së.

Zyrat rajonale të Drejtorisë i japin kopje të çertifikatës së vdekjes sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*): (i) librit amzë të lindjeve në vendin e lindjes, (ii) librit amzë të kurorëzimeve në vendin e kurorëzimit, (iii) zyrës përkatëse rajonale të MPB-së dhe (iv) zyrës përkatëse rajonale të KSHZ-së në vendin që është regjistruar si vendbanim i përhershëm. Në fund, informatat poashtu i përcillen edhe ESHS-së për qëllime statistikore.

Edhe pse Drejtoria është përgjegjëse për evidentimin e informatave personale që kanë të bëjnë me identitetin e qytetarëve, ajo nuk ia jep këto informata në mënyrë të drejtpërdrejtë KSHZ-së për ta përditësuar regjistrin e zgjedhësve. Në vend të kësaj, këto informata i jep MPB-ja, e cila i mbledh informatat për identitetin e njerëzve gjatë procesit të dhënies së letërnjoftimeve dhe pasaportave biometrike. Si pjesë e procesit të dhënies së dokumenteve,

MPB-ja i kopjon informatat e rëndësishme për identitetin e njeriut nga certifikatat e lindjes dhe të kurorëzimit të cilat i lëshon Drejtoria.

Fakti që informatat për identitetin e votuesve merren nëpërmjet një institucioni ndërmjetësues (MPB-së), e jo nga institucioni i cili ligjërisht është përgjegjës për evidentimin e tyre (Drejtoria), mund të shkaktojë mospërputhje ndërmjet informatave të përditësuara për identitetin dhe informatave për identitetin që janë raportuar nga MPB-ja. Kjo mundësi ekziston për shkak se MPB-ja i shënon ndryshimet e informatave të identitetit të ndonjë personi, vetëm atëherë kur ai i paraqet këto informata në formë të certifikuar kur bën kërkesë për letërnjoftim të ri ose dokument të ri udhëtimi. Një mospërputhje e tillë e të dhënave ka shumë gjasa të ndodhë në rastet kur ndonjë person e ndryshon emrin ose mbiemrin. Mospërputhjet në të dhënat që kanë të bëjnë me ngjarjet e tjera vitale të jetës, siç është lindja ose vdekja, ka shumë pak gjasa të ndodhin për shkak se zyrat rajonale të Drejtorisë ia përcjellin këto informata MPB-së sipas detyrës zyrtare.

Pasiqë zyrat rajonale të Drejtorisë informatat për vdekjet e regjistruara i dërgojnë sipas detyrës zyrtare, këto informata arrijnë në KSHZ nëpërmjet tre kanaleve të pavarura të komunikimit. I pari, Drejtoria i dërgon këto informata nëpërmjet zyrave rajonale të KSHZ-së. I dyti, informatat e njëjta poashtu i dërgohen edhe MPB-së, e cila këto informata ia jep KSHZ-së në përditësimin e parë të radhës së regjistrit të zgjedhësve. I treti, informatat i dërgohen drejtpërdrejt ESHS-së për përpunim statistikor. Prandaj, informatat që i dërgohen drejtpërdrejt KSHZ-së, kanë vlerë sa i përket përditësimit të regjistrit të zgjedhësve, vetëm në periudhën pas pranimit të përditësimit të fundit nga MPB-ja dhe derisa të finalizohen listat zgjedhore, pak para zgjedhjeve. Çdo herë kur MPB-ja dorëzon informata për përditësimin e regjistrit të zgjedhësve, ajo veçmë i ka të gjitha informatat për votuesit që kanë vdekur, të cilat paraprakisht i janë dërguar KSHZ-së. Ekipi u informua se ESHS-ja bën kontrollime të detajuara për të gjitha mospërputhjet e të dhënave (d.m.th vdekjet që janë raportuar nga zyrat rajonale të KSHZ-së, por që nuk janë raportuar nga MPB-ja). Si duket, raportimi i vdekjeve të evidentuara që i dërgohen drejtpërdrejt ESHS-së, nuk shfrytëzohet për përditësimin e regjistrit të zgjedhësve.

b) Lajmërimi i vendbanimit dhe dhënia e letërnjoftimit dhe dokumentit të udhëtimit me karakteristika biometrike

Në kontekst të regjistrimit të votuesve, informata për vendbanimin shfrytëzohet për të përcaktuar, në bazë të vendbanimit që është lajmëruar si i përhershëm, vendvotimin ku mund të ushtrohet e drejta e votimit. Për zgjedhjet lokale, adresat e banimit të votuesve poashtu e përcaktojnë edhe komunën ku një person mund të paraqitet si kandidat dhe komunën për të cilën ai/ajo ka të drejtë të votojë. Përveç vendbanimit të lajmëruar, të drejtën për të votuar e përcakton edhe posedimi i letërnjoftimit të vlefshëm ose i dokumentit të vlefshëm të udhëtimit.

MPB-ja është përgjegjëse për mbajtjen dhe përditësimin e evidencës për lajmërimin dhe çlajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe/ose të përkohshëm të qytetarëve, evidencës për dhënien e numrit unik amë dhe evidencës për letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit që janë dhënë. Me këtë grup gjithëpërfshirës të librave amzë, MPB-ja i posedon të gjitha informatat personale që janë të rëndësishme për identitetin, ngjarjet vitale të jetësor dhe

vendbanimin e çdo qytetari, duke i përfshirë edhe informatat për letërnjoftimet dhe pasaportat që u janë dhënë qytetarëve, si dhe vlefshmërinë e tyre.

Duhet theksuar se në aspekt të kompetencës ligjore për t'i evidentuar informatat personale, MPB-ja është përgjegjëse vetëm për evidentimin e vendbanimit, numrit unik amë dhe dhënien e letërnjoftimeve dhe të dokumenteve të udhëtimit. Evidentimi i informatave për identitetin që janë ligjërisht të vlefshme dhe informatave për ngjarjet vitale të jetës është përgjegjësi e MD-së, e cila mban libra të veçantë amzë ku ruhen këto informata. Në procesin e lajmërimit të vendbanimit ose të dhënies së letërnjoftimeve dhe/ose të dokumenteve të udhëtimit, MPB-ja i kopjon informatat që kanë të bëjnë me identitetin e ndonjë personi prej dokumenteve që e dëshmojnë identitetin (siç janë çertifikatat e lindjes dhe të shtetësisë) që janë lëshuar nga Drejtoria në kuadër të MD-së.

Lajmërimi i vendbanimit dhe dhënia e dokumenteve për qytetarët që jetojnë në vend

Lajmërimi dhe çlajmërimi i vendbanimit të përhershëm dhe/ose të përkohshëm të qytetarëve është i rregulluar me Ligjin për lajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe/ose të përkohshëm të qytetarëve. Neni 2 i këtij ligji parasheh se: “Vendbanimi i përhershëm duhet të jetë vend ku qytetari është vendosur me qëllim që aty të jetojë përherë dhe ku ai/ajo ka siguruar strehim.”.

Qytetarët që kanë për qëllim përherë të jetojnë në vend, duke i përfshirë edhe ata që përkohësisht banojnë jashtë vendit, janë të obliguar me ligj që ta lajmërojnë vendbanimin e përhershëm dhe ta lajmërojnë ndryshimin e vendbanimit të përhershëm. Gjatë ndryshimit të vendbanimit të përhershëm, qytetarët duhet të çlajmërohen nga vendbanimi i përhershëm ‘i vjetër’ dhe të lajmërohen në vendbanimin ‘e ri’ brenda tetë ditësh. Brenda 15 ditëve të tjera, MPB-ja duhet të sjellë vendim për ndryshimin e lajmëruar të vendbanimit të përhershëm. Mossjellja e vendimit (pozitiv ose negativ) nga MPB-ja sa i përket kërkesës së paraqitur për ndryshimin e vendbanimit, çon në një situatë ku parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të iniciojë një procedurë të gjatë administrative të ankimit.⁷ Vendbanimi i përhershëm i fëmijëve regjistrohet gjatë lindjes⁸ dhe gjatë çdo ndryshimi të ardhshëm të vendbanimit të prindërve të tyre. Moslajmërimi i vendbanimit në përputhje me kornizën ligjore sanksionohet me gjobë prej 100 euro deri në 500 euro, në përputhje me nenin 16 të Ligjit për lajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe të përkohshëm të qytetarëve. Për ta kompletuar lajmërimin e vendbanimit, qytetarët duhet të dorëzojnë dokumente që e dëshmojnë të drejtën për të banuar në pronën e dhënë.⁹

⁷ Në përputhje me nenin 3-b të Ligjit për lajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe të përkohshëm të qytetarëve.

⁸ Si duket, ky është implikim nga Dekreti, pika 24.

⁹ Në përputhje me nenin 2 të Ligjit për lajmërimin e vendbanimit të përhershëm dhe të përkohshëm të qytetarëve; kërkesa për dëshmi me anë të dokumenteve është përcaktuar me rregullativë të brendshme të MPB-së. Nga qytetarët poashtu kërkohet që ta lajmërojnë vendbanimin e tyre të përkohshëm, në qoftë se ndryshon nga vendbanimi i përhershëm, mirëpo këto procedura nuk u vlerësuan, për shkak se vendbanimi i përkohshëm nuk ndikon në listat zgjedhore.

Ka disa çështje që ndikojnë në saktësinë e informatave të evidentuara që kanë të bëjnë me vendin e vendbanimit të përhershëm. Pasi që lajmërimi i vendbanimit, e poashtu edhe ndryshimi i vendbanimit bëhet me kërkesë të qytetarëve, saktësia e informatës për vendbanimin e përhershëm varet nga lajmërimi me kohë i qytetarëve për atë se ku aktualisht banojnë. Megjithatë, pasi qytetarët ta kompletojnë lajmërimin e vendbanimit, si duket, MPB-ja bën kontrolle të kufizuara për të konstatuar se a vazhdojnë ata të jetojnë edhe më tutje në vendbanimin e lajmëruar dhe se a ekziston ende baza ligjore në bazë të së cilës është lajmëruar vendbanimi.¹⁰

Ligji parasheh se personi i cili nuk do ta lajmërojë vendin e saktë të banimit duhet të dënohet. Megjithatë, MPB-ja nuk ka mekanizëm për të konstatuar se a i plotëson personi edhe më tutje kushtet për ta ruajtur vendbanimin e tij ose të saj në vendin që e ka e lajmëruar. Edhe pse ligji parasheh një procedurë të detajuar për t'u ankuar ndaj vendimit të MPB-së për lajmërimin e vendbanimit, procedura e tillë mund të inicohet vetëm nga aplikuesi. Në të njëjtën kohë, banori i ri ose banorët e rinj nuk mund ta inicojnë procedurën për ndërprerjen e lajmërimin të vendbanimit, nëse ata janë vendosur në pronë, e cila edhe më tutje është vendbanim i ndonjë personi, ose pronari/pronarët e kanë ndërprerë kontratën për dhënie me qira me personin i cili e ka të paraqitur atë pronë si vendbanim i tij.

Lajmërimi i vendbanimit të përhershëm është ngushtë i lidhur me dhënien e letërnjoftimve dhe të dokumenteve të udhëtimit, për shkak se nëse ndonjë person e ndryshon vendbanimin e tij, ai ose ajo duhet ta ndryshojë edhe dokumentin e tij të identitetit. Lajmërimi i ndryshimit të vendbanimit për poseduesit e letërnjoftimeve dhe të dokumenteve të udhëtimit nënkupton se edhe ato duhet të ndryshohen, sepse adresa e banimit është e shtypur në të dyja këto dokumente. Duke pasur parasysh se marrja e dokumenteve të reja të identitetit mund të jetë një proces i gjatë, qytetarët mund të vendosin që ta shtyjnë për më vonë lajmërimin e ndryshimit të vendbanimit.

Evidentimi i dokumenteve dhe dhënia e tyre për qytetarët që jetojnë jashtë vendit

Qytetarët që jetojnë jashtë vendit dhe të cilët aplikojnë për dokument të ri të udhëtimit ose për ta zëvendësuar atë, duhet, në mes tjerash, të japin informatë për vendbanimin e tyre të përhershëm në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë¹¹, pa marrë parasysh faktin se ai mund të mos e ketë ndërmend të jetojë në vendbanimin që e ka deklaruar si të përhershëm. Edhe pse adresa e vendbanimit të përhershëm të qytetarit, në përgjithësi nënkupton lidhje ndërmjet individit dhe vendit në shtet, ku ai ose ajo do t'i realizojë të drejtat e tij ose të saj ligjore dhe do t'i kryejë përgjegjësitë e tij ose të saj, situata me qytetarët që jetojnë jashtë vendit mund të jetë ndryshe. Kjo veçanërisht vlen për diasporën dhe pasardhësit e tyre, të cilët, në përgjithësi, janë banorë të përhershëm jashtë vendit dhe shpeshherë mund të jenë qytetarë të shtetit ku banojnë.

¹⁰ Për shembull, ka mundësi që personi ta ketë shitur pronën ose ta ketë anuluar kontratën për dhënie me qira, por ta mbajë vendbanimin e lajmëruar në atë vend.

¹¹ Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 26 të Ligjit për dokumentet e udhëtimit të qytetarëve të "Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë".

Në përputhje me nenin 12 të Udhëzimit për mënyrën e dhënies së pasaportave dhe të pasaportave kolektive për qytetarët dhe Procedurën për dhënien e vizave për ato pasaporta, qytetarët, të cilët për çfarëdo qoftë arsyesh vazhdojnë të jetojnë jashtë vendit dhe të cilët nuk duan ose nuk mund ta lajmërojnë vendbanimin në territorin e shtetit, duhet të parashtrojnë kërkesë për marrje të dokumentit të udhëtimit deri te Ministria për Punë të Brendshme në bazë të vendbanimit të tyre të fundit”. Mirëpo, në praktikë, kjo dispozitë mund të rezultojë me situatë ku personat janë paraqitur në një vend të banimit (adresë), në të cilën ata nuk kanë të drejtë më të banojnë. Për shembull, prona që gjendet në adresën e fundit të lajmëruar të vendbanimit mund të mos ekzistojë më ose mund të jetë ndryshuar pronari i saj. Me kalimin e kohës, çështja ndërlikohet edhe më tepër me faktin se edhe pasardhësit e personit që jeton jashtë vendit e kanë si vendbanim të lajmëruar, vendbanimin e fundit të prindërve të tyre.

Qytetarët që jetojnë jashtë vendit dhe që kanë vendbanim të përhershëm në vend, janë të përfshirë në listat zgjedhore, sipas vendbanimit të tyre të fundit të përhershëm që është i lajmëruar dhe në listë janë të shënuar me një yll. Qytetarët që dalin jashtë vendit dhe kanë ndërmend që atje të jetojnë më shumë se tre muaj, duhet për këtë qëllim ta informojnë zyrën rajonale të MPB-së, pikat e kalimit kufitar ose zyrën konsulare jashtë vendit. Në të gjitha këto raste, njoftimet i dorëzohen MPB-së. Përfaqësuesit e Ministrisë për Punë të Jashtme e informuan ekipin se ata hasin në vështirësi gjatë konstatimit të vdekjeve të qytetarëve jashtë vendit, veçanërisht për ata qytetarë të cilët janë vendosur në mënyrë të përhershme jashtë vendit dhe të cilët nuk kanë pronë në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

c) Regjistri i adresave

Vendbanimi i përhershëm dhe ai i përkohshëm evidentohet në adresë konkrete, duke e përfshirë emrin e komunës dhe të qytetit ose të fshatit, emrin e rrugës dhe numrin e shtëpisë. Ka një bazë me të dhëna për ndarjen administrative të vendit, e cila udhëhiqet nga Regjistri qendror, që krijon një kod digjital unik për çdo rrugë të qyteteve dhe të fshatrave, ku ka sistem të rrugëve. Nuk ka kod digjital unik për numrat e shtëpive, edhe pse me gjasë, Regjistri qendror është duke e zhvilluar këtë mundësi; mirëpo kodi digjital unik për numrat e shtëpive nuk e përfshin kodin unik të rrugës.

Ndryshimi i emrave të rrugëve është në kompetencë të këshillave komunalë. Ndryshimi i emrit të ndonjë rruge ndikon në vlefshmërinë e dokumenteve personale për identifikim dhe mund të ketë pasoja në përpunimin e listave zgjedhore. Ekipi u informua për raste të izoluar, ku emrat e rrugëve në dokumentet e identifikimit të votuesve kanë qenë të ndryshme nga ato që kanë qenë të shtypura në listat zgjedhore. Në ato raste është vepruar në atë mënyrë që edhe emri ‘i vjetër’ i rrugës (që ka qenë i shënuar në dokumentin e identifikimit personal) edhe emri ‘i ri’ i rrugës janë futur në listën zgjedhore. Për shkak se dokumentet e reja kanë filluar të jepen relativisht para pak vitesh, dallimi ndërmjet emrave zyrtarë të rrugëve dhe emrave të rrugëve që janë të shtypur në letërnjoftime/dokumente të udhëtimit, deri tani është i vogël, mirëpo me kalimin e kohës mund të pritët që të rritet mospërputhja ndërmjet emrave zyrtarë të rrugëve me ato që janë të shtypur në letërnjoftime/dokumente të udhëtimit.

d) Këmbimi i informatave ndërmjet institucioneve shtetërore

Ekipi ka përshtypjen se edhe pse bëhet këmbimi i informatave për popullatën dhe votuesit ndërmjet institucioneve, kjo bëhet duke përdorur nivele të ndryshme të teknologjisë, duke përfshirë këmbimin e dokumenteve të shtypura në letër ose kopjimin e sasive të mëdha të të dhënave në kompakt disqe (CD), në vend që të mundësohet qasje e drejtpërdrejtë në të dhënat e institucioneve të tjera. Numri unik amë përdoret si kriter i vetëm për bashkërenditjen (përputhjen) e shënimeve personale nga bazat e ndryshme të të dhënave gjatë procesit të përditësimit të informatave personale në regjistrin e zgjedhësve dhe për ta siguruar integritetin e informatave personale në bazat e të dhënave. Numri unik amë poashtu shfrytëzohet si identifikues i vetëm gjatë përditësimit të informatave që merren në formë të letrës. Mbledhja e të dhënave biometrike që ruhen në një bazë me të dhëna të MPB-së, siguron se çdo person ka vetëm një shënim personal, të cilit i shoqërohet numër unik për identifikim dhe që mbron nga krijimi i më tepër shënimeve me numrin unik amë që i takon një personi.

Në realizim e sipër është një projekt i qeverisë për interoperabilitetin e të dhënave ndërmjet bazave të të dhënave që mbahen nga institucionet. Qëllimi kryesor i projektit është të eliminohen mundësitë për dyfishimin e aktiviteteve të institucioneve të ndryshme gjatë evidentimit të të dhënave dhe të sigurohet qasje e drejtpërdrejtë në të dhënat e përditësuara për institucionet e ndryshme. Nuk është e qartë se kur ky projekt do të japë rezultate praktike sa i përket evidentimit të qytetarëve dhe të votuesve. Edhe MPB-ja edhe Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë, të cilat e udhëheqin projektin për interoperabilitetin e të dhënave, theksuan se platforma për teknologji informatike të cilën e përdor MPB-ja, që është institucioni që udhëheq me sasinë më të madhe të informatave për popullatën dhe regjistrimin e votuesve, është e vjetër dhe që të rritet interoperabiliteti i të dhënave, teknologjia informatike e MBP-së duhet të avancohet. Është paraparë që ESHS-ja dhe KSHZ-ja të përfshihen në projektin për interoperabilitetin e të dhënave në fazën e tij të dytë.

e) Kompetenca për ndryshimin e informatave në listën zgjedhore

KSHZ-ja e ka kompetencën për mbikëqyrjen e saktësisë së informatave në regjistrin e zgjedhësve. Neni 42 (1) i Kodit zgjedhor parashesh se KSHZ-ja e ka për detyrë zyrtare të bëjë regjistrimin, plotësimin dhe fshirjen e të dhënave në Listën zgjedhore, në bazë të të dhënave nga librat e amzës, evidenca e vendbanimit dhe e shtetësisë, evidencat e tjera zyrtare dhe me kontrollim të drejtpërdrejtë. Kjo dispozitë përcakton se KSHZ-ja i bën ndryshimet në listat zgjedhore në bazë të evidencave zyrtare dhe poashtu i jep kompetencë KSHZ-së të bëjë ndryshime nëpërmjet kontrollimeve të drejtpërdrejta. Çka nënkupton kontrollimi i drejtpërdrejtë nuk është plotësisht e qartë.

Si duket, KSHZ-ja vepron duke u bazuar në atë se regjistrimi në listat zgjedhore, si dhe plotësimet dhe fshirjet në to, duhet të bëhen vetëm në bazë të informatave që janë ligjërish të vlefshme nga librat e amzës dhe evidencat e vendbanimit. Edhe pse disa anëtarë të KSHZ-së e pranuan përgjegjësinë e KSHZ-së për ta ndryshuar regjistrin e zgjedhësve nëpërmjet kontrollimeve të drejtpërdrejta, nuk ka procedura për një kontrollim të tillë. Megjithatë, ekipi u informua se shpeshherë në procesin e përditësimit të të dhënave të votuesve, dhe në rastet kur ka mospërputhje ndërmjet informatave që janë pranuar nga institucionet e ndryshme,

informata e saktë përcaktohet nëpërmjet kontrollimit të drejtpërdrejtë. Gjasa janë shumë të vogla që KSHZ-së t'i jepet kompetenca të bëjë ndryshime në të dhënat e regjistrit të votuesve nëpërmjet kontrollimit të drejtpërdrejtë, si për shembull nëpërmjet vizitave derë-më-derë, pa u siguruar se të dhënat janë ligjërish të vlefshme. Megjithatë, mungon një qartësim preciz ligjor i kësaj dispozite.

Ekipi erdhi në përfundim se KSHZ-ja bën kontrollim të kufizuar të listave zgjedhore dhe se nuk janë provuar të gjitha mundësitë për të bërë pyetësorë në bazën e të dhënave të regjistrit të votuesve, që do të mund t'i nxirrte në shesh problemet eventuale me regjistrimin e votuesve, siç është numri i pazakonshëm i vendbanimeve të reja të evidentuara në zona të caktuara pak para mbajtjes së zgjedhjeve ose numri jashtëzakonisht i madh i banorëve që janë evidentuar në një adresë të caktuar. Në rastin kur regjistri i votuesve bazohet vetëm në të dhënat që janë ligjërish të vlefshme nga librat e amzës dhe evidenca e vendbanimeve, informatat në regjistrin e zgjedhësve do të jenë po aq të sakta, sa janë edhe në librin e amzës dhe në evidencën e vendbanimeve. Prandaj, saktësia e listave zgjedhore është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me saktësinë e librave të amzës dhe të evidencës së vendbanimeve, me ç'rast kontrollimi i listave zgjedhore, në fakt paraqet kontrollim të punës së kryer nga institucionet që i kanë ofruar të dhënat. Në rrethana të tilla, më së shumti që mund të bëjë KSHZ-ja është t'i potencojë problemet e mundshme që kanë të bëjnë me të dhënat që i ka pranuar për përditësimin e regjistrit të votuesve, dhe në të njëjtën kohë, prej saj nuk mund të kërkohet përgjegjësi për informatat jo të sakta në listat zgjedhore, përderisa ato përputhen plotësisht me të dhënat që i ka pranuar nga institucionet relevante.

V. AVANCIMI I MBLEDHJES DHE I KËMBIMIT TË INFORMATAVE NË TË ARDHMEN

Në përgjithësi, korniza ligjore i përmban të gjitha ligjet e nevojshme për mbajtjen e evidencës së saktë të librave të amzës, vendbanimeve, letërnjoftimeve dhe dokumenteve të udhëtimit. Autoritetet mund ta shqyrtojnë mundësinë për ndryshimin e akteve nënligjore, në mënyrë që të përmirësohet edhe më shumë evidentimi i vendbanimeve të përhershme të qytetarëve. Kushtet për dhënien e dokumenteve të udhëtimit për qytetarët që banojnë në mënyrë të përhershme jashtë vendit ka nevojë të përmirësohen edhe më shumë.

Ka përmirësime që mund të bëhen në aspekt afatshkurtë deri në afat të mesëm, si dhe në aspekt afatgjatë. Aktivitetet afatshkurta duhet të përqëndrohen në përpjekjet e menjëhershme për rikthimin e besimit të publikut, ndërsa në aspekt afatgjatë, vendimet duhet të merren duke u bazuar në një marrëveshje të gjerë politike, për të vendosur një sistem transparent të evidentimit që do të implementohet në mënyrë sistematike dhe do ta gëzojë besimin dhe respektin e publikut.

AKTIVITETET QË MUND TË NDËRMERREN NË AFAT TË SHKURTË

Si masë për ndërtimin e besimit me qëllim të përmirësimit të transparencës së regjistrimit të votuesve, KSHZ-ja mund të përpilojë disa pyetësorë për ta analizuar regjistrin e zgjedhësve, i tillë siç është pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Anliza mund të bazohet në disa pyetësorë,

duke kërkuar në regjistrin e zgjedhësve grupe të mundshme të shënimeve shumëfishta. Pyetëtorët mund të ekzekutohen rregullisht nga ESHS-ja, në emër të KSHZ-së. Pika fillestare në përpilimin e këtyre pyetësorëve mund të jetë Aneksi 2 (Pyetëtorët e mundshëm për identifikimin e grupeve të mundshme të shënimeve shumëfishta) i këtij raporti, që nuk duhet të merret si shembull i vetëm.

Poashtu, KSHZ-ja mund të përpilojë një fletë informative që rregullisht të ofrojë informata statistikore për çdo komunë, për atë se sa letërnjoftime dhe dokumente të reja udhëtimi janë dhënë, për lajmërimet dhe çlajmërimet e vendbanimeve të përhershme, si dhe informata të tjera të rëndësishme për përpilimin e listave të sakta zgjedhore. Poashtu, me anë të një rregulle të brendshme të KSHZ-së, mund të parashihet që pyetëtorët e tillë të ekzekutohen rregullisht dhe rezultatet të bëhen publike. Gjatë periudhës së shikimit publik të listës zgjedhore, pyetëtorët mund të ekzekutohen për çdo ditë dhe rezultatet e tyre të publikohen poashtu për çdo ditë.

Duke e pasur parasysh se një analizë e tillë nënkupton kontrollimin e punës së institucioneve të tjera që ofrojnë të dhëna në procesin e regjistrimit të votuesve, gradualisht mund të hiqet nga përdorimi kërkesa që KSHZ-ja të bëjë kontrollimin e të dhënave dhe të mbajë përgjegjësi për saktësinë e tyre dhe kjo përgjegjësi t'u transferohet institucioneve që janë përgjegjëse për ofrimin e të dhënave që shërbejnë për përditësimin e listave zgjedhore.

Poashtu mund të shqyrtohet edhe tërësia e akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me evidentimin e ngjarjeve vitale të jetës, shtetësisë dhe vendbanimeve të përhershme, me qëllim të përmirësimit të rregullave të vjetëruara dhe vlerësimit të mundësive për harmonizimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore, duke i marrë parasysh teknologjitë aktuale për mbajtjen e librave përkatës amzë. Poashtu, ky shqyrtim mund të konfirmojë se nuk ka aktivitete të dyfishta gjatë transferimit të informatave në KSHZ nga institucionet relevante.¹²

Duhet të përgatiten zgjidhje ligjore dhe praktike që do të sigurojnë se qytetarët do ta respektojnë dispozitën për ta lajmëruar ndryshimin e vendbanimit. Për këtë qëllim, duhet të promovohen mënyra për nxitjen e qytetarëve që ta lajmërojnë ndryshimin e vendbanimit dhe zgjidhja nuk duhet të bazohet vetëm në dënime. Për t'u siguruar se vendbanimi i evidentuar është i saktë, pronarëve të pronave duhet t'u ofrohet mekanizëm që të kundërshtojnë që vendbanimi të evidentohet në pronën e tyre, nëse personi nuk jeton më në pronën e tyre ose nëse marrëveshja për dhënie të pronës me qira ka përfunduar.

Sa i përket njoftimit për votuesit që kanë vdekur, këto informata Drejtoria duhet t'ia përcjellë drejtpërdrejt ESHS-së, duke pasur parasysh se një kanal i tillë i komunikimit tashmë ekziston. Për shkak se Drejtoria këto informata ia transmeton edhe MPB-së, për ta përmirësuar procesin e njoftimit për personat e vdekur, zyrat rajonale të Drejtorisë duhet drejtpërdrejt ta informojnë ESHS-në për personat e vdekur vetëm në periudhën pasi të shpallen zgjedhjet, duke filluar nga përditësimi më i fundit i regjistrit të votuesve që është pranuar nga MPB-ja, deri në ditën e fundit të mbylljes së listave zgjedhore.

¹² Edhe pse masa e dublimit mund të konsiderohet si kontrollim i dyfishtë, ajo mbetet e tepërt.

Duhet gjetur mënyra të veçanta për t'i informuar në kohë, sipas detyrës zyrtare, të gjitha institucionet që janë të përfshira në përpilimin e listave zgjedhore, për ndryshimin e emrave që janë rezultat i martesës ose divorcit, në mënyrë që listat zgjedhore t'i përmbajnë të dy emrat, edhe "të vjetrin" edhe "të riun".

Ndryshimi i vendbanimit nënkupton edhe ndryshim të dokumenteve për identifikim personal, gjë që mund t'i dekurajojë njerëzit për ta lajmëruar ndryshimin e vendbanimit; si rezultat i kësaj, personat e tillë, në listat zgjedhore, do të gjenden në vende ku, në fakt, nuk jetojnë. Letërnjoftimet ose dokumentet e udhëtimit duhet të përdoren vetëm për ta vërtetuar identitetin e njerëzve dhe adresa nuk duhet domosdoshmërisht të shihet si informatë e identitetit.

Duhet të hiqet kushti që votuesit të cilët jetojnë përherë jashtë vendit dhe i realizojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në vendet ku jetojnë, të deklarojnë adresë të vendbanimit të përhershëm në Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në vend të kësaj, ata duhet vetëm ta deklarojnë vendin e origjinës së tyre familjare, si dëshmi për lidhjen e tyre me vendin e prejardhës së tyre.

AKTIVITETET QË MUND TË NDËRMERREN NË AFAT TË GJATË

Në aspekt afatgjatë, Kodi zgjedhor parasheh se KSHZ-ja duhet ta ndërtojë kapacitetin e saj të brendshëm për t'a përpunuar regjistrin e zgjedhësve për t'i mbajtur informatat e listave zgjedhore. Për këtë qëllim, KSHZ-ja duhet të punojë në përgatitjen e përkrahjes teknike për implementimin e një sistemi të tillë, ku duhet të përfshihen burimet adekuate njerëzore dhe të definohen harxhimet vjetore për funksionimin e sistemit, para se të fillohet me implementimin e tij. Implementimi i një sistemi të tillë mund të vlerësohet në aspekt të efektivitetit në raport me harxhimet për të udhëhequr një regjistër votuesish paralelisht me librat e tjerë amzë të qytetarëve dhe në veçanti në krahasim me librin aktual amzë që mbahet nga MPB-ja ose me ndonjë libër të ardhshëm amzë që duhet të krijohet nga Drejtoria.

Për të siguruar shpërndarje të saktë të votuesve në vendvotimet e tyre më të afërta, duhet të përmirësohet baza e të dhënave të rrugëve dhe të adresave që mbahet nga Regjistri qendror dhe ajo të transformohet në një regjistër adresash duke futur në përdorim kode unike digjitale në nivel të shtëpive, hyrjeve dhe numrave të banesave. Kjo qasje do ta përmirësonte edhe më shumë vendosjen e lidhjes unike ndërmjet identitetit të personit dhe vendit të tij gjeografik. Si rezultat i kësaj, evidenca e vendbanimeve do të krijohet duke u bazuar në librin amzë që i përmban të dhënat e identitetit për të gjithë qytetarët rezidentë dhe në regjistrin e adresave që do t'i përfshinte të gjitha adresat ekzistuese.

Duhet t'i jepet prioritet përfshirjes së ESHS-së dhe të KSHZ-së në projektin për interoperabilitetin e të dhënave, që aktualisht luan një rol të rëndësishëm në përpilimin e listave zgjedhore.

Mund të jetë e dobishme që në të ardhmen të vlerësohet efektiviteti në raport me harxhimet për mbajtjen e regjistrat të votuesve paralelisht me librat amzë të qytetarëve që mbahen nga MPB-ja ose nga Drejtoria në kuadër të MD-së. Në këtë kontekst, duhet shqyrtuar se a duhet ndonjëherë nga këto dy institucione, që kanë kompetencë ligjore për evidentimin e informatave

personale, të jenë kompetente edhe për përpilimin e listave zgjedhore në bazë të informatave që i kanë prej më parë, dhe a duhet arritur një konsensus politik për një vendim të tillë. Vlerësimi i tillë duhet t'i marrë parasysh përmirësimet që janë duke u bërë në menaxhimin e informatave personale nëpërmjet projektit për krijimin e librit elektronik amzë, krijimin e kushteve teknike për interoperabilitetin e informatave digjitale që gjenden në bazat e të dhënave të institucioneve relevante dhe faktin se KSHZ-ja nuk ka kompetencë t'i ndryshojë informatat personale në regjistrin e zgjedhësve që janë në kundërshtim me informatat e vlefshme ligjore.

Përndryshe, është e domosdoshme që të zhvillohet në tërësi kapaciteti i KSHZ-së për ta marrë kompetencën për udhëheqjen e regjistrit të votuesve.

ANEKSI 1 – LISTA E TAKIMEVE

INSTITUCIONET SHETËRORE

Komisioni shtetëror i zgjedhjeve (KSHZ)

Z. Boris Kondarko, kryetar
Z. Subhi Jakup Jakupi, zëvendëskryetar
Z. Sasho Sërcev, anëtar
Zsh. Aneta Stefanovska, anëtare
Zsh. Violeta Duma, anëtare
Z. Vlatko Sajkoski, anëtar
Z. Bedredin Ibraimi, anëtar
Zsh. Biljana Stojanovska, sekretare e përgjithshme
Z. Rasim Mustafa, zëvendëssekretar i përgjithshëm
Z. Bllagoja Stojkovski – këshilltar shtetëror, sektori i listave zgjedhore.
Z. Vllado Vasiljevski – shef i sektorit për teknologji informatike
Z. Aleksandar Sofronijoski – shef i njësisë për listat zgjedhore
Zsh. Neda Xhoçkova – këshilltare në sektorin e listave zgjedhore

Enti shtetëror për statistikë (ESHS)

Zsh. Blagica Novkovska, drejtore e ESHS-së
Zsh. Nermina Gjurgjeviq, këshilltare për përgatitjen dhe përditësimin e listave zgjedhore
Zsh. Mira Deleva, shefe e njësitit për përpunim kompjuterik të listave zgjedhore
Z. Goran Kiranxhiski, njësia për definimin e ndarjes territoriale të vendvotimeve

Zyra rajonale e KSHZ-së në Çair

Z. Izeir Neziri, shef i zyrës rajonale të KSHZ-së në Çair

Ministria për Punë të Brendshme

Zsh. Nadica Velevska, sektori për çështje administrative dhe të kontrollit

Drejtoria për mbajtje të librave të amzës në kuadër të Ministrisë për Drejtësi

Z. Ashim Zekirovski, drejtor
Zsh. Katerina Bitrovska, zëdhënëse
Z. Aco Novevski, shef i Zyrës rajonale në Shkup

Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë

Z. Igor Cërvenov, sektori për interoperabilitet

Ministria e Punëve të Jashtme

Z. Zvonimir Popoviq, drejtor për çështje konsullare

Regjistri Qendror

Z. Andrea Popovski, shef i sektorit për mirëmbajtje të regjistrave
Zsh. Ana Trajçeva, këshilltare dhe person i autorizuar për mirëmbajtjen e regjistrit të adresave
Zsh. Gajtana Kasapova Sotirovska, shefe për zgjidhje të TI-së

PËRFAQËSUESIT E PARTIVE POLITIKE

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)

Z. Abdilaqim Ademi, ministër për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)

Z. Bekim Fazliu, deputet

Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë (LSDM)

Z. Damjan Mançevski, zëvendëskryetar

Dr. Renata Treneska – Deskoska, anëtare e Këshillit ekzekutiv

Organizata e Brendshme Revolucionare e Maqedonisë – Partia Demokratike për unitet kombëtar maqedonas (VMRO-DPMNE)

Z. Ilija Ilijovski, Anëtar i Grupit punues për përditësimin e listave zgjedhore

SHOQËRIA CIVILE

OJQ-ja MOST

Zsh. Rosana Aleksoska,

Z. Zlatko Dimitrioski

Aneksi 2

Pyetësorët e mundshëm për identifikimin e grupeve potenciale të shënimeve të shumëfishta

Të kërkohen shënimet, te të cilat përputhen fushat e mëposhtme:

1. Numri unik amë është i njëjtë, por informatat e tjera personale janë ose të njëjta ose të ndryshme;
2. Emri, mbiemri, emri i nënës (ose i babait) dhe viti i lindjes;
3. Emri, mbiemri, emri i nënës (ose i babait) dhe datëlindja;
4. Emri, mbiemri, emri i nënës (ose i babait) dhe muaji i lindjes;
5. Emri, mbiemri, emri i nënës (ose i babait), por datëlindja dallon për një shifër;
6. Emri, emri i nënës (ose i babait), datëlindja, por mbiemri dallon në një shkronjë dhe e ka numrin e njëjtë të shkronjave (gjatësia maksimale e mbiemrit është M shkronja);¹³
7. Mbiemri, emri i nënës (ose i babait), datëlindja, por emri dallon në një shkronjë dhe e ka numrin e njëjtë të shkronjave (gjatësia maksimale e emrit është N shkronja);
8. Emri, mbiemri, datëlindja, por emri i nënës (ose i babait) dallon në një shkronjë dhe e ka numrin e njëjtë të shkronjave (gjatësia maksimale e emrit është N shkronja)
9. Emri, emri i nënës (ose i babait) dhe datëlindja, por mbiemri dallon dhe gjinia është femër.

Vërejtje 1. Pyetësorët 6-8 mund të përsëriten duke lejuar që dallimi të jetë më shumë se një shkronjë.

Vërejtje 2. Mund të përgatiten pyetësorë të veçantë për t'i identifikuar grupet e mundshme të shënimeve të shumëfishta që të eliminohen shënimet e dyfishta.

Vërejtje 3. Mund të përgatiten pyetësorë të veçantë për t'i konstatuar rastet e mundshme të personave që kanë më shumë se një numër unik të amzës ose personat me numër të njëjtë amze, veçanërisht njerëzit e moshuar.

Vërejtje 4. Në rast se mund të përdoren të dhëna të tjera nga librat e amzës, pyetësorët e mësipërm mund të ndryshohen sipas nevojës.

¹³ Vlerat e M dhe N (më poshtë) duhet caktohen më parë, në bazë të statistikave për emrat dhe/ose mbiemrat në gjuhën përkatëse.

PËR OSBE/ODIHR-IN

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit i vitit 1992). Kjo njihet si dimensionin njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për zgjedhje të lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, ku bëjnë pjesë të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot ajo ka mbi 130 të punësuar.

OSBE/ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me Përkushtimet e OSBE-së, standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe legjislacionin nacional. Metodologjia e saj unike, ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, OSBE/ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare ta përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet për demokratizim të ODIHR-it përfshijnë: sundimin e ligjit, përkrahjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e qarkullimit, dhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i implementon disa programe për ndihmë në vit që kanë qëllim të caktuar, duke dashur t'i zhvillojë strukturat demokratike.

OSBE/ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin obligimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, që është në përputhje me përkushtimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe siguria e tyre.

Në fushën e tolerancës dhe të mosdiskriminimit, OSBE/ODIHR-u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuara në këto fusha: legjislacionin, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrjen, raportimin dhe përcjelljen e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitetet edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe të mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikën që kanë të bëjnë me romët dhe sintit. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të romëve dhe të sintive në organet vendimmarrëse. Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet e OSBE-së dhe misionet e saj në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informata për ODIHR-in gjenden në ueb-faqen e saj (www.osce.org/odihr).